



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2268/4 prot

Datë 26.10.2022

V E N D I M

K.P.P. 1046/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.10.2022 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-40208-08-30-2022, me objekt: “*Blerje tonerash per printera dhe fotokopje*” me fond limit 6.014.079 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Tirane.
- Ankimues:** “InfoSoft Office” SHPK.
Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi i Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Tirane.
Rr. “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.09.2022, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-40208-08-30-2022, me objekt: “Blerje tonerash per printera dhe fotokopje” me fond limit 6014079 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Tirane.

II.2. Në datë 29.09.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 07.10.2022, ka përfunduar klasifikimi përfundimtar i ofertave dhe janë njoftuar operatorët ekonomikë me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.) si më poshtë:

1. “InfoSoft Office” SHPK	1.377.077,60 lekë, skualifikuar
2. “IT Gjergji Kompjuter” SHPK	1.727.940,85 lekë, skualifikuar
3. “ADD Print” SHPK	1.944.888,00 lekë, skualifikuar
4. “Blueprint Technologies” SHPK	2.997.000,00 lekë, skualifikuar
5. “Librari Dyrrahu” SHPK	4.061.200,00 lekë, skualifikuar
6. “Marketing & Distributions” SHPK	5.779.788,00 lekë, kualifikuar

II.4. Më datë 07.10.2022 autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike ka njoftuar operatorin ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për vlerësimin e procedurës së prokurimit, nga ku rezulton se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

Pasi për printerin HP DeskJet 845, KYOCERA Ecosys P3145dn, dhe për fotokopjen Toshiba E studio 307, operatori ekonomik ka dorëzuar mostra ekuivalente, por rezulton i paplotësuar nga operatori ekonomik kriteri: “Operatori ekonomik duhet të deklarojë se tonerat origjinale përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit. Emri i prodhuesit të jetë i stampuar në pullën e sigurisë tek kutia, (paketimi) e bojës (tonerit), ose në pullën e sigurisë në kartrixhe.”, pra nuk përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit në kutinë e bojës ose në kartrixhe.”

II.4.1. Në datën 10.10.2022, është publikuar njoftim fituesi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.4.2. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 17.10.2022, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2268/2022 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2617 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-40208-08-30-2022, me objekt: “Blerje tonerash per printera dhe fotokopje” me fond limit 6.014.079 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Tirane.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.4.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2268/2 prot., datë 18.10.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime se plotësohen.

II.4.4. Me shkresën nr. 5245/20 prot., datë 20.10.2022, protokolluar me tonën me nr. 2268/3 prot., datë 24.10.2022, me objekt “Kthim përgjigje”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, bashkëngjitur Vendimi nr.18, datë 20.10.2022 mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se është vendosur pranimi plotësisht i ankesës, nga ana e KSHA-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK dhe me Vendimin nr.18, datë 20.10.2022 KSHA ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës për të gjitha pretendimet e ngritura nga ankimuesi, lidhur me arsyet e skualifikimit të tij.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e*

autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.

REF-40208-08-30-2022, me objekt: “Blerje tonerash per printera dhe fotokopje” me fond limit 6.014.079 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor Tirane.

2. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.
3. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

